

SEJDI GASHI

**DISA VEÇORI TË AREALIT GJUHËSOR TË ISTOGUT
ME RRETHINË, SI DHE MBI DISA TOPONIME TË KËSAJ ANE,
TË SHËNUARA NË DEFTERIN E SANXHAKUT TË SHKODRËS
TË VITIT 1485**

Hyrje

Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës dhe ka Istogun qendër kryesore administrative (qendër komunale). Istogu nga verilindja kufizohet me komunën e Zubin Potokut, nga lindja me Komunën e Skenderajt, në jug me Klinën, nga jugperëndimi dhe perëndimi kufizohet me Komunën e Pejës, kurse në pjesën veriore me Malin e Zi (Komuna e Rozhajës) dhe me Serbinë (Sanxhaku-Komuna e Tutinit).

Prej autorëve që janë marrë me studimin e folklorit dhe të gjuhës së Trevës së Istogut i pari është Vuk Karaxhiqi, i cili në vitin 1830 ka bërë mbledhjen e disa këngëve popullore nga Gurrakoci, me ç'rast ka bërë edhe një studim përmbledhës gjuhësor mbi këtë të folme.

Më vonë, më 1912, studiuesi Norbert Jokl, mbi bazën e materialeve të Karaxhiqit, botoi në Vjenë studimin e vet të parë mbi gjuhën shqipe të banorëve të Gjurakovcit – Gurrakocit (*Grup autorësh, 1973: 702*).

Vite me vonë, Treva e Istogut, nga aspekte dhe këndvështrime të ndryshme (gjeografik, historik, etnografik, onomastik), si dhe ndonjë trajtesë për ndonjë vendbanim të veçantë, është trajtuar nga këta autorë dhe në këto botime:

Gliša Elezović, *Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta*, Beograd, 1932; Halil Kajtazi, *Disa emra toponimesh në shqipet*, "Perparimi", 3/1965; Halil Kajtazi, *Disa emra toponimesh*, "Perparimi", 5/1968; Ismail Berisha, *Banja (Ilixha) afër Pejës*, 1972;

Grup autorësh, *Kosova dikur e sot*, Beograd, 1973; Svetozar Stijević, *Onomastika jednog dela Metohijskog Podgora*, SANU, Onomatološki prilozi I, Beograd, 1979; Milovan Radovanović, *Varošica Istog u Metohijskom Podguru*, Zbornik radova Geografskog instituta, Beograd, 1979; Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, vëll. I, "Mihal Duri Tiranë, 1974; Aleksandër Stipčević, *Ilirët-jeta-kultura*, Prishtinë, 1980; Zef Mirdita, *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*,

“Rilindja”, Prishtinë, 1981; Milica Grković, *Imena u Dečanskim hrisobuljama*, Novi Sad, 1983;

Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1984;

Svetozar Stijević, *Onomastika jednog dela porečja Kujevaće*, SANU, Onomatološki prilozi V, Beograd, 1984;

Rexhep Doçi, *Iliro-shqiptarët dhe serbët në Kosovë (sipas onomastikës)*, Prishtinë, 1994;

Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, IAP, Prishtinë, 1995;



Fejz Drançolli, *Ndërtimi i kultit të krishterë iliro-shqiptarë*, Dardania Sacra, 2, Prishtinë, 2000; Sylë Dreshaj, *Fshtati Krye-Vrellë prej themelimit deri në vitin 1977*, Pejë, 2002; Sadik Bicaj, *Tipat dhe mënyrat e fjalëformimit në mikrotoponiminë e Istogut me disa fshatra*, në: Artikuj gjuhësorë praktikë, Prishtinë, 1996;

Rrustem Rugova, *Varret e përbashkëta, Mizoritë serbe dhe qëndresa shqiptare në Rrethin e Istogut*, Prishtinë, 1997; Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur (monografi etnologjike)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2003; Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës - Burimi (Istogu)*, Vëll. 12, Prishtinë, 2004; Milovan Oradović, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2005; Harta Arkeologjike e Kosovës II, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Prishtinë, 2011; Sejdi Gashi - *Materiale leksikore nga Istogu me rrethinë (projekt shkencor)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014; Abdullah Zymberi, *Fjalor popullor me rreth 20000 fjalë*, Prishtinë, 2015; Naim Berisha, *Vëzhgime në leksikon dialektor të Rrafshit të Dukagjinit* (Disertacioni i doktoratës në dorëshkrim), QSA, Tiranë, 2016.

Në studimet e lartpërmendura, ku më shumë e ku më pak, pra në një formë apo tjetër, ka zënë vend e folmja në vështrim, megjithëkëtë mendojmë se ky areal nuk është studiuar në masën dhe mënyrën e duhur.

Disa veçori të arealit gjuhësor të Istogut me rrethinë si dhe mbi disa toponime...

Pozita gjeografike e Istogut në kuadër të Republikës së Kosovës



Karakteristikat dialektore të së folmes së Istogut me rrethinë

Shqipja e folur në Istog e rrethinë ruan pak elemente të vjetra dhe më shumë të reja, si në rrafshin leksikor e fonetik, ashtu edhe në atë morfologjik. Elementet e reja në këtë areal të gegërishtes verilindore mendojmë se janë krijuar si rezultat i kontaktit të gjatë dhe të pareshtur me të folmet fqinje dhe krahasuar me të kaluarën, mund të thuhet se kjo e folme ka pësuar disa ndryshime dialektore. Megjithëkëtë, në të folmen në vështrim këto dallime më shumë shpërfaqen në të folur dhe më pak në të shkruar.

Areali gjuhësor në trajtim, gradualisht, në rrjedhë të moteve, ka pësuar disa ndryshime të vogla, por që mund të hetohen. Faktorët si: arsimimi më masiv i popullsisë, frekuentimi i institucioneve kulturore, shfrytëzimi i literaturës në shqipen standarde, mjetet e informacionit (gazeta, radio, TV e së fundmi edhe interneti, lëvizjet e popullsisë, martesat me të huajt, procesi i globalizimit dhe faktorë të tjerë të karakterit shoqëror dhe jo shoqëror, kanë shkaktuar lëkundje në gamën e veçorive gjuhësore të rrethit të Istogut.

Çdo ditë e më shumë, në trevën tonë gjuhësore, si kudo tjetër në Kosovë, po vdesin pjesëtarë të gjeneratave të vjetra, kështu, bashkë me ta po vdes edhe një pjesë e pasurive gjuhësore që nuk janë vjelë deri më tani, ndërkaq, popullsia e moshës së re, shumica me shkollim të mesëm dhe atë universitar, në masë të konsiderueshme zotërojnë dhe flasin shqipen standarde.

Komunikimi i tyre (i të rinjve) në variantin lokal të së folmes së Istogut më shumë zhvillohet në situata joformale dhe si i tillë ky lloj komunikimi po zbehet dita-ditës, ndërkaq banorët e moshuar komunikojnë kryesisht në dialekt (idiomën e Istogut).

Megjithëkëtë, kontakti dhe marrëdhëniet e vazhdueshme me trevat e tjera të Kosovës ka bërë që në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë të kemi raste të përzierjes së kodeve gjuhësore, si dhe modifikime në planin fonetik, morfologjik e më pak në atë sintaksor. Situata të tilla gjuhësore më së lehti mund të vërehen në rastet e martesave të istogasve me gra që nuk i takojnë trevës së tyre gjuhësore.

Nga ana tjetër, siç dihet, modernizimi dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës, avancimi i mjeteve dhe i metodave për kryerjen e punëve në përditshmërinë e banorëve të rrethit të Istogut, kanë bërë që shumë fjalë të leksikut të kësaj treve të kalojnë në pasivitet, disa të tjera të pësojnë bartje kuptimore e disa të tjera, sipas nevojës, të huazohen apo të krijohen fjalë të reja (neologjizma). Prandaj, në ditët tona mund të thuhet se në arealin

gjuhësor në vështrim, kërkimet dialektologjike, menjëherë dhe pa vonesë, duhet të shtrihen më shumë dhe më intensivisht, sepse më pas mund të jetë vonë.

Më poshtë, në pika të shkurtra po paraqesim disa nga veçoritë fonetike të së folmes sonë.

Zanoret

Siç dihet “*njësitë fonetike të gjuhës mund të studiohen nga aspekte të ndryshme dhe ndër këto njësi, tingujt zënë një vend të veçantë*” (Dodi, 2004:14). Meqenëse e folmja shqipe e trevës së Istogut bën pjesë në gegërishten verilindore, mund të themi se në përgjithësi sistemi tingullor i saj përkon me atë të këtyre të folmeve.

Një ndër veçoritë e sistemit fonetik të së folmes së Istogut është hundorëzimi (nazalizimi i zanoreve), mirëpo shënohen raste kur një zanore e mirëfilltë hundore është denazalizuar. Kështu, në këtë plan, në arealin tonë gjuhësor, janë të hetueshme ndryshimet në mënyrën e shqiptimit të zanores hundore (*â*) dhe zanores (*ë*), ashtu siç vërehen variacione për gjatësinë e zanoreve, shqiptimin e togjeve të zanoreve (diftongjeve).

Për të pasur njohuri më të plota për gjendjen e zanoreve në të folmen tonë, do të bëjmë përshkrimin e secilës zanore (pra ato gojore dhe hundore), të togjeve të zanoreve, si dhe diftongjeve.

Duhet theksuar fakti se zanoret e arealit gjuhësor në shqyrtim janë të njëjta ose të ngjashme me të folmet e tjera të dialektit verior të shqipes, me përjashtim të disa rasteve ku ekzistojnë dallime në mënyrën e shqiptimit të tyre.

Gjatësia e zanoreve

Në trevën tonë gjuhësore, si në shumicën e të folmeve shqipe, dallohen fjalë me tri radhë zanoresh:

a) Fjalë me zanore të shkurtër (p.sh. *dësh, tërjelë, fërr, lög, shtëg, lăgt, măs* etj.)

Përveç këtyre fjalëve, me zanore të shkurtër dalin edhe këto trajta dhe pjesë të ligjëratës:

- nyjat e përparme (*i, e, të*), p.sh. *ī mirë, ě mirë, të (<të mirë)*;

- disa mbaresa, pjesë përbërëse e trajtave foljore, si: *lexonī, knojshă, hajshě, msovă, knofshī*;

- disa pjesë të pandryshueshme të ligjëratës:

parafjalët (*tě, mě*)

ndajfoljet (*kăh, něr*)

lidhëzat (*dhě, ě*)

pjesëzat (*sě, ů*) - (shih edhe: Mulaku, 2005:30).

b) Fjalë me zanore të mesme (p.sh. *tërrjela, thësi, fërri, lōgu, shtëgu, lāgu, māti* etj.)

c) Fjalë me zanore të gjatë (p.sh. *me ārdh, me zbārdh, sahī, timīt, alltī, me msū, me knū* etj.).

Sa u përket zanoreve të gjata, vlen të theksohet fakti se në arealin gjuhësor të Istogut ky tip zanoresh më shpesh haset te ato fjalë që gjatë zhvillimit të tyre historik kanë pësuar rënie të ndonjë tingulli ose rrokjeje. Prandaj, forma e tyre e sotme është e ndryshme nga e kaluara, p.sh. *me tfillū*; në disa raste edhe: *me fūllu* (nga: *met fūlluem*), *me shūt* (*me shitun*), *me knū* (*me këndumun/ me knumun/* etj.).

Në këtë trevë gjuhësore kam vërejtur se fjalët me një zanore të theksuar janë dukshëm më të shumta se sa ato me zanore të patheksuar. Situata e ngjashme mbretëron edhe përgjatë pjesës më të madhe të gegërishtes, prandaj areali gjuhësor në shqyrtim nuk dallon shumë prej të folmeve të tjera gegërishte.

Togjet e zanoreve

Shqipja e folur në Istog e rrethinë për kohë të gjatë ka qenë në kontakt dhe bashkëjetesë me gjuhën turke dhe atë serbe. Prandaj, kontakti i tillë ndërgjuhësor ka bërë që në të folmen tonë, në të shumtën e herëve, diftongjet *ie, ye, ae, oe* dhe *ue* të paraqiten të monoftonguara.

Nazalizimi dhe denazalizimi i zanoreve

Dialekti i gegërishtes, në dallim nga toskërishtja, në vete përmban, përveç zanoreve gojore, edhe ato hundore, pra dy radhë fonemash zanore. Zanore të tilla (gojore dhe hundore) gjallojnë edhe në trevën tonë gjuhësore. Siç dihet, me çështjen e hundorësisë së zanorëve ndër të folme të shqipes janë marrë studiues vendorë dhe të huaj.

Shqipja e Istogut bën pjesë në grupin e gegërishtes verilindore dhe deri më sot ka ruajtur tri zanore hundore: (â, ê, î). Hundorësia në këtë të folme është e llojit primar dhe sekondar. Ja disa shembuj: *nâna, bâna, sâna, thâna, rrfâna, dhâmi* etj. Në shembuj e dhënë dhe në të tjerë të këtij lloji, zanorja hundore â, paraqitet me nuancë labializimi dhe për këtë shkak e kemi shënuar kështu (*â°*); *nâ°na, bâ°na, sâ°na, thâ°na*.

Edhe zanorja tjetër hundore ê shqiptohet me një intensitet mesatar të hundorësisë, p.sh. *flēj, frēz, tērshan, gērshan* etj., ndërkaq zanorja hundore î, në të folmen në shikim, mund të vërehet në këto fjalë: *hî (hîn), fî, sinî* etj.

Lëvizjet e theksit

Kur kemi të bëjmë me lëvizjen e theksit në të folmen në kundërim, mund të themi se dukuria e tillë më shumë është e shprehur te një numër i

fjalëve të origjinës orientale (kryesisht turke) dhe te huazimet sllave. Pra, theksi është zhvendosur prej vendit të tij të zakonshëm në një vend tjetër në trup të fjalës, duke iu përshtatur natyrës së gjuhës shqipe. Dukuria e tillë e lëvizjes së theksit ka prekur edhe fushën e toponimisë dhe të mikrotoponimisë, p.sh. **Starasëll** (mikrotoponim në male, sipër katundit Mojstir), **Studenic, Kashic**.

Në të folmen tonë, lëvizje të theksit nga rrokja e fundit në atë të parafundit vërehet edhe te një numër i fjalëve me origjinë turke, te fjalë paraoksite, p.sh. (*hise, penxhere, dajre, xhenaze, kafe, pare* etj.), mirëpo nuk ndodh kështu në disa të folme të tjera shqipe, veçmas në toskërishte, ku këto fjalë dalin me theks fundor p.sh. (*hisë, penxherë, dajrë, xhenazë, kafë* etj.). Përveç këtyre, edhe disa emra të njerëzve, gjësendeve etj., kanë pësuar lëvizje të theksit, pra nga theksi fundor në atë parafundor (paraoksiton), p.sh. *njeri* < *njëri, qiri* < *qiri* etj. Në këto raste, përveç lëvizjes së theksit, paraqiten ndryshime edhe në aspektin morfologjik, pra kemi të bëjmë me ndërrim të lakimit, nga lakimi i dytë në atë të parë. Mbi këtë parim pra dëgjohen edhe sintagmat: *njëri i mtr, prej/pej njërit t' mtr* etj. Edhe përemri vetor i vetës së tretë njëjës (*ai*), në të këtë të folme paraqitet me theks paraoksiton *ai* < *qj*, pra në këtë rast theksi nuk bie të zanorja (*i*), por mbi zanoren (*a*).

Bashkëtingëlloret

Sa i përket sistemit konsonantik (bashkëtingëllor), areali gjuhësor i Istogut me rrethinë në përgjithësi përkon me atë të mbarë gegërishtes, veçmas me gegërishten verilindore. Në këtë plan, ky areal, sikurse edhe të folmet e tjera të Kosovës, dallohet për nga rrafshimi i tingujve palatalë *q* dhe *gj* në bashkëtingëllore afrikate (*ç, xh*), pra tingujt palatalë (bashkëtingëlloret mesgjuhore *q* dhe *gj*) kanë prirjen të kalojnë në bashkëtingëlloret paragjuhore *ç* dhe *xh*, përkatësisht në tingujt: *ç* dhe *ğ*.

Në trevën tonë gjuhësore, në mënyrë fare të qartë dallohet tingulli *ɲ*, tingull ky që nuk e ka as shqipja standarde e as të folmet e arealit toskë. Fonema *ɲ*, është përfutur si rezultat i kontraksionit të grupit konsonantik *ng*. Pra, këtu tingulli *ɲ*, ashtu si dhe në të folme të tjera të Kosovës, gjen përdorim mjaft të dendur: *long* < *loɲ, opangë, opang, < opâɲ, mëngë* < *mâɲ, kam hangër* < *kam hânɲ, jam nguju* < *jam ɲuju* etj.

Dukuritë dhe proceset fonetike të lartshënuara do të trajtohen në mënyrë më të plotë në pjesën që ka të bëjë me fonetikën.

Mbi topikun Istog

Në territorin e kësaj komune hasen mjaft gjurmë dhe mbetje të vendbanimeve antike. Arkeologët, në bazë të ekspeditave hulumtuese në

këtë trevë, kanë pohuar se përgjithësisht, territori i komunës së Istogut ka qenë i banuar që nga kohët e lashta.

Sa i përket etimologjisë së topikut Istog, gjuhëtari Qemal Murati thekson se fjala Istog “rrjedh nga një emër vetjak homonim” (Murati, 2014:41-42), pohim ky me të cilin pajtohem edhe ne. Pra, pajtohem që topikut Istog rrjedh prej një antroponimi. Studiuesi Murati, emrin Istog e krahason me patronimin *Stoche* - familje trogirase, *Romanus Stoche* 1259, *Marinus Stoche* 1270, *Maurus Stoche* 1272. Këto të dhëna studiuesi Murati i nxjerr nga të dhënat e historianit Konstandin Jireček (*Jireček*, 1962:343). Pra, Murati mendon se toponimi Istog, sipas gjasash, rrjedh prej një antroponimi *Stoche*, që kishte dhënë një patronim me të njëjtin emërtim, por në rastin e Istogut, duke ia paravënë një *i*-protetike, sipas ligjeve të turqishtes, njëlloj si tek Shkup-Yskup (Murati, 2014:42).

Në dokumentet e shkruara për herë të parë Istogu përmendet në krisobulat kishtarë të vitit 1314 në kohën e mbretit Stefan Uroshi III. Në këtë dokument përmendet rruga që shpie nga Istogu në Bellopojë. Po ashtu përmendet edhe në kartën e mbretit Dushan të vitit 1348 në Manastirin e Shenjësorëve Mihail dhe Gabriel afër Prizrenit.

Dëshmi të ekzistencës së topikut të sotëm Istog edhe gjatë pushtimit osman në këto anë na ofron Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485. Në këtë defter, Istogu paraqitet me emrin *Istranmeshi*, me 10 shtëpi e 8 beqarë (*Pulaha*, 1974:300). Tre shekuj më vonë, pra më 1761, Istogu përmendet në regjistrin e Manastirit të Deviqit (*Devički Katastig*) jo si vendbanim, por vetëm si emër lumi, ndërkaq si katund, Istogu përmendet në Fjalorin e Vuk Karagjiqit (*Elezović*, 1932:343).

Gjatë pushtimit osman Istogu kishte filluar të zhvillohej. Kështu ishin vënë hapat e parë drejt një industrializimi, pra u ndërtuan shumë mullinjtë me ujë, si dhe u sollën makineri për përpunimin e leshit (*Grup autorësh*, 1973:701).

“Sulme” mbi autoktoninë shqiptare në Istog e rrethinë

Në aspektin historik, jo rrallëherë është pohuar se popullsia shqiptare e rrethit të Istogut, ashtu si edhe ajo e gjithë Kosovës, nuk janë vendas dhe janë të ardhur nga viset malore të Shqipërisë së sotme. Mendojmë që pohime të tilla janë jo shkencore dhe që nuk kanë të bëjnë aspak me realitetin, sepse në truallin e sotëm të Istogut me rrethinë që moti kanë banuar shqiptarë. Dëshmitë që përpiqet t’i paraqesë Jovan Cvijić (*Cvijić*, 1966) janë siguruar nga ana e tij pa asnjë kriter shkencor dhe sipas gjasave i takojnë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX (*Jastrebov*, 1901).

Ashtu si kudo në botë ku mund të ketë lëvizje të popullsisë, edhe në rrethin e Istogut, parë në aspektin historik, sigurisht që ka pasur lëvizje të tilla, por jo të llojit që përshkruhen nga historiografia serbe. Të qenët autokton në trojet e lashta shqiptare në rrethin e Istogut fare lehtë mund të argumentohet përmes antroponimisë së kahmotshme shqiptare, e pranishme në këto troje të lashta. Megjithëkëtë, propaganda serbe bëri përpjekje që të sjellë dëshmi në favor të saj, duke u ndalur në disa dokumente kishtarë serbe që i përkasin Mesjetës, sepse edhe në njërin prej dokumenteve, siç është Krisobula e Deçanit, emrat e banorëve të përkatësisë së etnosit shqiptar paraqiteshin të përzier me ata sllavë. (*Gashi, 1979:59-102*).

Nga ana tjetër, studiuesi Selami Pulaha (*Pulaha:1972-193-272*) sqaron se në shek. XV popullsia e ziametit të Altun-Ilisë, ku bënte pjesë edhe Istogu me rrethinë, ishte me shumicë popullsi shqiptare, prandaj sipas këtij studiuesi, kjo gjendje mund të dëshmohet fare lehtë përmes emrave vetjakë tipikë shqiptarë nga kjo zonë, si: Lekë, Kolë, Gjin, Gjon, Progon, Marek, Martë, Pal etj.

Çështja e lëvizjes së popullsisë në zonën e Dukagjinit, ku bën pjesë edhe Istogu, ka qenë objekt i shumë trajtimeve dhe diskutimeve, kryesisht nga historiografia e huaj, e më pak nga ajo shqiptare. Në lidhje me këtë, burimet e sakta dhe shkencore janë fare të pakta.

Krahas historiografëve, edhe gjuhëtarët dhe dijetarët e fushave të tjera janë përpjekur që të ndriçojnë aspekte të caktuara që lidhen më problemën e autoktonisë shqiptare në trevat e tyre. Në lidhje me këtë problematikë, studiuesi Idriz Ajeti ka vënë re dy elemente tejet të rëndësishme:

a) numri i emrave vetjakë shqiptarë që figurojnë në Regjistrin e Sanxhakut të Shkodrës del më i madh se ai i emrave vetjakë sllavë (*Ajeti, 1975:18*).

b) emrave vetjakë shqiptarë ishte zakon që t'u vihej atributi (epiteti) Arbanas, gjë që shihet qartë në defterin e lartcekur, por edhe në dokumente të tjera osmane të kohës (*po aty*).

Sipas përbërjes etnike të banorëve, në Istog e rrethinë jetojnë: shqiptarët, që janë shumicë (mbi 94%), boshnjakët, serbët, egjiptianët, ashkalijtë dhe romët, si dhe një pakicë fare e vogël e përkatësisë turke.

Sipas regjistrimeve të vitit 1981 tri fshatra apo 6 % prej gjithsej 52 fshatrave, janë etnikisht të pastra, pra ka vetëm banorë shqiptarë (Studenica, Veriqi i Ri dhe Llugat), ndërkaq, siç dihet, në periudhën kohore të pasluftës së vitit 1999, ky raport ka ndryshuar dukshëm.

Rrethi i Istogut historikisht ka qenë i banuar me shumicë shqiptare. Këtë e dëshmojnë edhe dy regjistrimet e popullsisë që i ka bërë Mbretëria serbe, kroate, sllovene. Sipas regjistrimit të vitit 1913, rrethi i Istogut ka pasur 18.000 banorë, mbi 90 % shqiptarë. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1921 rrethi i Istogut ka pasur 20.159 banorë, prej tyre 14.501 janë deklaruar shqiptarë dhe 5.658 serbë. Ndryshimet më të mëdha demografike në dëm të etnisë shqiptare kanë ndodhur pas viteve '20 të shekullit XX. Largime me dhunë të popullsisë shqiptare nga rrethi i Istogut ka pasur edhe në kohën midis dy Luftërave Botërore, për të arritur kulminacionin në kohën e Aksionit Famëkeq të Mbledhjes së Armëve, që ishte organizuar mbi qëllime të pastra politike nga aparati i dhunshëm shtetëror Jugosllav. Këto metoda që aplikoi pushteti jugosllav, duke përdorur mjete të kombinuara të një terrori të organizuar shtetëror, kishin për qëllim që me çdo kusht të ndryshohej struktura demografike e popullsisë shqiptare. Natyrisht, kjo ishte në favor të plotë të popullsisë serbe dhe malazeze. Gjatë kësaj kohe, sipas vlerësimeve të bëra, ka pasur deri në 20 % rritje të popullsisë sllave në strukturën e përgjithshme të banorëve të Rrethit të Istogut.

Kur kemi të bëjmë me përkatësinë e popullsisë sipas besimeve fetare në rrethin e Istogut, mund të themi se shumica e banorëve janë të besimit islam, por ka edhe shqiptarë të besimit katolik, veçmas në fshatin Gurrakoc. Pra, edhe në të kaluarën popullsia e këtyre anëve ka qenë shqiptare dhe për këtë nuk ka dyshime (*Pulaha, 1983:16*), pavarësisht nga konvertimet fetare që kanë ndodhur ndërkohë.

Sa i përket gjendjes së popullsisë në rrethin e Istogut, në ditët tona, ajo paraqitet mjaft e qëndrueshme në aspektin e mobilitetit hapësinor. Aty-këtu haset dukuria e përzierjes së strukturës kombëtare që realizohet me anë të martesave. Këto bëhen kryesisht nga të rinjtë e Istogut, të cilët për qëllime të punësimit kanë migruar në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë dhe shumë prej tyre kanë krijuar familje. Kështu pra, shumë prej tyre herë pas here kthehen në vendlindje dhe në këtë mënyrë ndikojnë sadopak në përzierjen etnike të popullsisë së kësaj ane.

Toponimet dhe mikrotoponimet nga komuna e Istogut

BANJA: Vendbanim i lashtë iliro-dardan, rreth 15 kilometra në jugperëndim të Istogut (Populli: Bâja e Pejës, Bâja -Ilinxhja, Ilinxhja)

Patronimet: Bacaj, Mulaj, Sutaj, Hetemaj, Gashi, Dreshaj, Elshani, Sylaj, Morina, Mavraj, Bicaj etj.

Mikrotoponimet e këtij lokaliteti janë: Uji i Tharbt, Bregu i Ilinxhes, Gorromeli, Te ekonomia, Kërrshi i Ilinxhës etj.

Banja përmendet në dokumentet osmane të kohës (DSSH)¹, me emrin Bana (Pulaha, 1974:204) me 54 shtëpi, 2 beqarë dhe 4 të veja.

BAICA: Lokalitet me shtrirje në të dyja anët e rrugës automobilistike Pejë-Gurakoc, rreth 17 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Maksutaj Loxha, Ukaj, Lutaj, Morina, Kastrati, Leskova, si dhe disa familje myslimane (boshnjake), ashkali dhe malazezë.

Mikrotoponimet: Lugu i Drinit, Muvraku, Dylybregu, Ara e Spahisë, Osoja, Arat e Gata, Dydeshti, Homniku etj. Lokalitet ilir i kohës romake (monedha antike, stoli dhe unazë nga bronzi, shigjeta lufte) nga koha e hekurit dhe mesjeta e hershme. Në DSSH, figuron me emrin Balic (Pulaha, 1974:63) me 9 shtëpi, 2 beqarë dhe 2 të veja.

BELICA: Vendbanim i tipit kodrinor-malor, rreth 13 kilometra në juglindje të Istogut. Për nga struktura etnike është vendbanim i përzier me serbë (shumicë) dhe shqiptarë.

Patronimet: Mulaj dhe Halitaj. Mikrotoponimet: Balega, Kopite, Kuçishte, Qeshmja, Dragall, Orrnica, Buçalla, Bashte, Otava, Shtab etj. Në DSSH përmendet me emrin Bjeliça me 20 shtëpi, 5 beqarë dhe 1 e ve (Pulaha, 1974:302).

BELLOPOJA: Vendbanim fushor, rreth 8 kilometra në juglindje të Istogut. Patronimet: Aliu si dhe disa familje serbe, bonjake dhe shkali.

Patronimet: Selmanaj, Ukaj si dhe disa familje serbe.

Mikrotoponimet: Pamuka, Batallaku, Imerovica, Drenjani, Joshe, Qesta, Orrnica, Drumina, Lokava etj. (shih edhe: Stijović, 1982: 292). Fillimisht përmendet në Kartën e mbretit Uroshi I (1254- 1264) më vonë përmendet në kristobulën kishtarë të mbretit Dushan të vitit 1348. Nuk figuron në DSSH 1485, por me emrin Bellopojë-Podgur, haset në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (Osmani, 2004:77). Në Joshe, varrezave të lashta (shenja dhe simbole me motive kishtarë) - (Zadužbine Kosova, 1987:397).

CARALLUKA: Vendbanim fushor, i tipit të grumbulluar, rreth 15 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: Rugova, Podrimaj, Sutaj, Sylaj, Xhema, Pejaj etj., si dhe disa familje serbe dhe ashkali. Mikrotoponimet: Kroni i Carrallukës, Livadhet e Zajmit, Fushat, Kraishta e Sutit, Ara e Plakut, Arat e Rexhëmehmetëve, Livadhi i Stanit etj.

Janë zbuluar varreza të vjetra që mendohet se janë varreza ilire të periudhës romake.

¹ Defteri i Sanxhakut të Shkodës.

Në DSSH 1485 përmendet me emrin Çirnalug me 6 shtëpi e 2 beqarë (Pulaha, 1974:246).

CËRKOLEZI: Vendbanim kodrinor-malor, rrëzë maleve, rreth 12 km, në verilindje të Istogut. Patronimet: Mahmutaj, Balaj, Ymeraj, Sadrijaj, Jasharaj, si dhe disa familje serbe.

Mikrotoponimet: Gradina, Prilepi, Te Gropa e Uçalive, Rubniku, Mella, Vërbica, Kroni i Vërbices, Kurilla, Arat e Xhenazës, Shpella e Oshlakut, Kërrshina, Kape, Livadhet te Hanit, Lipa, Boronjaku, Samari, Shpella e Klysyres etj. Fillimisht përmendet më 1395, në Kartën e Princeshës Milica - që ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Shenjtë. Ndërkaq, në DSSH përmendet me emrin Cërkolaz, me 40 shtëpi, 6 beqarë dhe 1 të ve (Pulaha, 1974:200). Në vendin e quajtur Arat e Xhenazës - themele të objekteve të vjetra, kurse te Livadhet te Hani - mbeturina të materialit ndërtimor: tulla dhe gurë të themeleve të lashta.

CËRRCA: Vendbanim fushor i tipit të grumbulluar. Shtrihet përgjatë dy anëve të rrugës Istog-Vrellë, rreth 2 km në perëndim të Istogut. Patronimet: Rugova, Hasanaj, Kalijani, Haskaj, Rexhaj, Blakaj.

Mikrotoponimet: Gropat e Kaçakve, Corrovoda, Drushtimi, Golaku, Gurrat e Bardha, Direkt e Kullave, Sorodoli, Bajshe, Kralica, Lugu i Zajmit, Lluga, Koroniqet, Golina, Shpellat Binake, Karamuqolle, Maja e Cërrcës, Guri i Kuq, Livadhet e Buta, Kashkavalli, Kroni i Morrave, Shpellat e Golakut, Rosuja etj. Fillimisht përmendet më 1348 në kartën e mbretit Dushan, si dhe në Manastirin e Shenjtorëve, Gabriel e Mihajl, afër Prizrenit (Novaković, 1912, 682). Më 1485 në DSSH me emrin Çerniça me 16 shtëpi, 2 beqarë e 1 të ve (Pulaha, 1974:242).

DOBRUSHA: Vendbanim kodrinor. Shtrihet përgjatë dy anëve të rrugës magjistrale Pejë-Mitrovicë, rreth 10 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: Muçaj, Maxharraj, Tuzi, Demaj, Hajdaraj, Berisha, Mulliqi, Dreshaj, Nikçi, Morina, Pacaj, Elshani, Mehmetaj, Selimaj, si dhe familje kolone boshnjake, serbe e malazeze.

Mikrotoponimet: Vuçari, Te Bunari, Kroni i Hajdutit, Epodrum, Kanali i Maxharrit, Ledina, Valla, Lluga, Bregu, Kërla etj. Fillimisht përmendet më 1326 me emrin Dobrushnica në kartën e Stefan Dushanit, si dhe më 1348 në Kartën e Car Dushanit. Në DSSH (1485) përmendet me emrin Dobroshi i Madh, me 20 shtëpi, 4 beqarë dhe 1 të ve (Pulaha, 1974:189).

DRAGOLECI – Vendbanim fushor, rreth 3 km, në juglindje të Istogut.

Patronimet: Avdijaj, Hysenaj, Kajtazi, Kastrati, Cakutaj, Ujupaj (shkali) dhe një familje serbe. Mikrotoponimet: Dushkaja, Rosule, Medreza, Agraxha, Jazi i Begut, Progonet, Kroni i Sasit, Verrishta, Livadhet e Gata, Joshe, Në grykë të Livadheve etj. Dragoleci përmendet më 1348 në Kartën e Shenjtërorëve Gabriel e Mihail të Prizrenit me 80 shtëpi, nga të cilat 15 të forta (Stijović, 1984:237). Si Dragonofc përmendet i shënuar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893.

DREJA- Vendbanim i tipit të shpërndarë, rreth 10 km në juglindje të Istogut.

Patronimet: Zagraxha, Zeqiraj, Imeraj, Gashi, Malaj, Pukaj, Dedaj, Raqa, Rraci, Kapiti, Abazaj, Kosovali, Noshaj. Mikrotoponimet: Trolli i Vjetër, Kroni n'Ulicë, Arat te Rrahi, Livadhi i Din Imerit, Lluga e Becit, Kodrat e Kokajve, Kujafçi, Kodra e Malishganit, Livadhet e Thata, Lluga e Vidhit, Bunari i Avdisë etj. Te Trolli i Vjetër - copa tullash, tjegullash, copa metali, që dëshmojnë se aty ka ekzistuar një vendbanim i vjetër. Me emrin Dren përmendet më 1893 në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

DUBOVA E VOGËL: Vendbanim fushor, në anën e majtë të Drinit të Bardhë, rreth 8 km në jugperëndim të Istogut. Patronimet: Bacaj, Daci, Kelmendi, Lajçi, Demaj, Hasaj, Mehaj, si dhe disa familje boshnjake e malazeze.

Mikrotoponimet: Seishta, Rroshet, Ara e Verrit, Orashkë, Livadhi i Demë Hysës, Batmoni etj. Fillimisht përmendet në kartën e princeshës Milica në vitin 1395, që këtë lokalitet ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Shën Pantelejit (Novaković, 1912:520). Dubova në DSSH më 1485, kishte 9 shtëpi, 3 beqarë dhe 1 të vejë (Pulaha, 1974:280).

DUBRAVA: Vendbanim fushor, rreth 2 km në lindje të Istogut. Patronimet: Ibrahimaj, Bajramaj, Avdijaj, Sylaj, Kajtazaj, si dhe familje boshnjake, ashkali, rome, malazeze e serbe. Mikrotoponimet: Raveci, Udha e Drenicës, Rakita, Jellashi, Kllaqunari etj. Fillimisht me emrin Dobrina, me 10 shtëpi e 3 beqarë, përmendet në DSSH më 1485 (Pulaha, 1974: 66).

GURRAKOCI: Një prej 4 bashkësive lokale të komunës, rreth 7 km në jug të Istogut. Patronimet: Fetahaj, Kabashi, Osmanaj, Ferati, Palokaj, Musolli, Jahaj, Ferati, Bajramaj, si dhe disa familje ashkali dhe serbe. Mikrotoponimet: Ledina e Fetahve, Gurrat e Kocit, Jazi i Gogës, Shavarinat, Vorret e Kqija, Livadhi i Madh, Arat e Shushicës, Lluga, Batallaku, Kroni i Ukëbajramëve, Kodra e Peqinëve, Bostanishta, Mesir, Terazije, Gusari, Qulina, Lisi i Kishës etj. Me emrin Gjerbçishta, me 17

shtëpi e 4 beqarë, përmendet më 1845 në DSSH (Pulaha, 1974: 162). Në një hartë austriake të vitit 1689, është i regjistruar me emrin Gurakoz.

ISTOGU: Qendër komunale. Shtrihet buzë Malit të Moknës, në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Ndryshe quhet Podgur.

Patronimet: Bytyçi, Bujupaj, Buleshkaj, Bajra, Hysenaj, Jahaj, Ferati, Haxhijaj, Gashi, Blakaj, Gorani, Gusturani, Ademaj, Demiraj, Alushaj, Nimanaj, Jakupi, Kelmendi, Gegolli.

Mikrotoponimet: Livadhet e Istogut, Prroni i Çaushtit, Lugu i Kojzaqës, Lugu i Markut, Livadhet e Strellcit, Lugu i Plepave, Kërrshi i Vneshtës, Livadhet e Synesë, Kërrshi i Epërm, Quka e Vogël, Kërrshi i Samarit, Livadhet e Zheginës, Kërrshi i Sokolit, Kodra e Koronës, Kërrshi i Burimit, Selillat Kërrshi i Ravnit, Ledina e Gjenovaqës, Bira e Arushës, Quka e Madhe, Livadhi i Avdylit etj. Në Golinë shihen gjurmë të rrugës antike (koha romake). Fillimisht përmendet më 1314, në Krisobulat Kishtare të Stefan Deçanit. Më 1348 përmendet në kartën e mbretit Dushan të manastirit të Shenjësorëve Mihail dhe Gabriel afër Prizrenit (Radovanović, 1959:175). Në DSSH 1485, përmendet me emrin Istranmeshi, me 10 shtëpi e 8 beqarë (Pulaha, 1974:300).

ISTOGU I POSHTËM: Vendbanim fushor, rreth 1 km nga qendra e Istogut.

Patronimet: Sylaj, Hulaj, Ademaj, Bajra, Kurtaj, Llapi, Alihajdari, Buleshkaj, Dekaj, Hysenaj, Delijaj, Arifaj, Mehmetukaj.

Mikrotoponimet: Lenishta, Arat e Alihajdarëve, Baltaku, Arat e Sylajve, Selishta, Rroshel, Lluga, Arat e Gata, Prroni i Çaushtit, Arat te Qoshi, Krivaça, Medreza, Janilla, Grezda, Arat e Malit, Te Huli, Bojxhaku, Muleci. Midis dy Luftërave Botërore e deri në fillim të viteve 1950, shumë familje shqiptare të këtij fshati, nga terrori dhe dhuna serbe, janë detyruar të shpërngulen në Shqipëri dhe Turqi.

KAMENICA: Vendbanim fushor, rreth 8 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Metaj dhe Lipaj. Mikrotoponimet: Ura e Delisë, Ara e Hasan Agës, Ura e Devollit, Temali, Livadhi i Vogël, Ara mi Kullë, Orrnica, Anej Prronit, Livadhi i Poshtë, Lisat e Ahmet Vuthit, Prroni i Kumllës etj. Ky katund është themeluar rreth 150 vjet më parë. Familjet e para që janë vendosur në këtë lokalitet janë: Gashi – familje e ardhur nga Çubrelë i Drenicës, si dhe familja Kelmendi nga katundi Lipë – komuna e Pejës.

KALIÇANI: Vendbanim kodrinor, i tipit të grumbulluar, rreth 12 km në perëndim të Istogut. Shtrihet buzë Malit të Korenikut.

Disa veçori të arealit gjuhësor të Istogut me rrethinë si dhe mbi disa toponime...

Patronimet: Zogaj, Metaj, Ukaj, Sejdaj, Arifaj, Selmanaj, Cakutaj, dhe Osmanaj.

Mikrotoponimet: Roga e Shalës, Podi i Gjongegs, Dydeshti, Arat e Bujës, Livadhi i Gjoks, Fusha e Hasapalit, Livadhi i Markut, Koroniku, Hakanishta, Lugishta e Palgjonit, Kërshi i Gjongegs, Kërshi i Pappleks, Bira e Arushës, Brini i Lecit, Kroni i Magjupit, Lugishta e Hasapalit, Shpella e Kadisë, Lojzet, Merleket, Kroni i Zanave, Kroni i Azës, Shkalla e Kaliçanit, Kroni i Zabelit, Mali i Tapave, Brrakat, Rudaku, Qafa e Zhigut, Lugu i Shtjerrave, Gropa e Nuses, Lugu i Belegut, Livadhi i Kishës, Lisi i Kaçamakut, Hithat, Gërbiba, Lugu i Kuajve, Xhuherja, Kallaba, Gropa e Shoshanit, Rrgalla, Bregu i Kikës, Xhuherja, Gurt e Arushës etj. Te Arat e Bujës janë të dukshme gërmadhat e objekteve të vjetra, ndërkaq në vendin e quajtur Livadhi i Kishës ekzistojnë themelet e një kishe të vjetër shqiptare. Më 1485 përmendet në DSSH me emrin **Dolina Kaliçani** me 3 shtëpi dhe 2 beqarë (Pulaha, 1974:306).

KASHICA: Vendbanim fushor. Pjesë e katundeve të buzë Drinit të Bardhë, rreth 15 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Nurçaj, Brahimaj, Shoshi, Berisha, Kelmendi dhe Krasniqi.

Mikrotoponimet: Jalloshat, Livadhi i Madh, Ara e Madhe, Poilla, Seishta, Ostrika, Shavarina etj. Fillimisht përmendet në DSSH 1485 me emrin **Kshica**, me 7 shtëpi dhe 2 beqarë (Pulaha, 1974:281). Rreth 300 vjet më vonë përmendet në regjistrin e Manastirit të Deviqit të vitit 1770-1780.

KËRNINA: Vendbanim kodrinor, rreth 12 kilometra në lindje të Istogut.

Patronimet: Çitaku, Hasanaj, Sylaj, Shala, Boletini, Memaj, Metaj, Alidemaj, Dani. Mikrotoponimet: Starasella, Llazova, Lisi i Orlit, Belibregu, Shpia e Miftar Kushës, Sejishta, Zabeli, Buquku, Gjingjeri, Bregu, Te Kisha e Llugiqit, Kroni i Magjupit, Lugu i Gjânë, Broqishta, Gubafci, Osmonica, Kalanica, Ceroviku, Çukafci, Tërshovina, Banishori, Kodra, Arat e Gata, Stojefci, Begllaqa, Berishta, Lugu i Mllakut, Arat e Rexhës, Te Kroni i Rakoshit, Rrushet e Memiqve, Otava, Arat e Mdhaja, Zhdrella etj. Në Tërshovinë është një mur i vjetër që mendohet se i takon një kishe ilire. Te Kroni i Rakoshit, hasen gjurmë të një vendbanimi të vjetër, sepse në kodër ekzistojnë gërmadhat e një kishe (populli: Kishë rimo-katolike) - mikrotoponimi -Te Kisha e Llugiqit. Fillimisht përmendet në DSSH 1485 me emrin Kërnina, me 5 shtëpi, 1 beqar e 1 të ve (Pulaha, 1974:332).

KOSHI: Vendbanim, rreth 20 km në juglindje të qytetit të Istogut.

Patronimet: Delijaj, Ukaj, Frrokaj, Paloku, Oroshaj, Gojani, Neziraj (ashkali), Oprashka dhe Maleshaj (ashkali) dhe disa familje serbe.

Mikrotoponimet: Bakaqa, Bregu i Samarxhisë, Zabeli, Broqishta, Jazbina, Kosharnik, Ledina, Bregu, Utrina e Deviqit, Te Kisha, Vragovc, Llokve, Te lisat, Ara e Madhe, Valloga, Llojza, Oprashka, Manove etj.

Përmendet më 1314 në krisobulën e Shën Stefanit dhe mbretit Milutin (Stijević, 1982:396). Në DSSH më 1485, përmendet me emrin Kus, me 55 shtëpi, 11 beqarë, 3 të veja (Pulaha, 1974:287).

KOVRAGA: Vendbanim fushor, rreth 6 km në juglindje të Istogut. Sipas gërmimeve arkeologjike dëshmohej që është vendbanim iliro-dardan.

Patronimet: Blakaj, Belegu, Vërbiqi, Lucaj, Salihu, Gjocaj, Loshaj, Osmanaj, Haxhijaj etj.

Mikrotoponimet: Shushica, Mi Vadat, Nër Vadat, Çymyraqa, Rrahishta, Errnica, Podina e Korragëve, Bunari te Karaulla, Hajdone, Bregjet etj. Më 1485 në DSSH përmendet me emrin **Kovaliq**, me 8 shtëpi, 1 beqar, 2 të veja (Pulaha, 1974:252).

LLUGA: Vendbanim fushor, i tipit të shpërndarë, rreth 6 km në jug të Istogut. Patronimet: Balaj, Hysenaj, Zekaj, Hajdinaj, Metalijaj, Kukleci, Ibërdemaj, Imeraj, Blakaj, Sejday, Përgjegjaj, Meshi (Morinë) etj.

Mikrotoponimet: Ara nër Dardhë, Orrnica, Zabeli, Bashkallaku, Livadhi i Bojkut, Shavarina, Litecet etj. Në afërsi të lagjes Metalijaj dhe asaj Hajdinaj gjenden varreza të moçme katolike-shqiptare. Ndryshe ky katund quhet Llugat e Isniqit, për arsye se shumica e banorëve janë të ardhur nga Isniqi i Deçanit.

LLUKAVCI I BEGUT: Vendbanim fushor, rreth 5 km në jug të Istogut.

Patronimet: Blakaj, Rugova, Visoqi, Curri, Shabanaj, Berisha, Gërguri, Mehaj, Goruzhda, Zhabolli, Llumnica, si dhe disa familje boshnjake, serbe e malazeze.

Mikrotoponimet: Rrahi, Zallina, Arat e Kronit, Baltaku, Prroni i Zhezheçicave, Bishti i Maxhupit, Ara nër kumlla, Arat te Frashnat, Verrishta, Livadhet e Egra etj.

Në të kaluarën në këtë lokalitet nuk banonte askush, ishte tokë moçalore. Pronar i saj ishte Osman Begu, prandaj, për këtë arsye, ky katund në emrin e vet përmban atributin (i Begut). Për herë të parë me emrin e sotëm, është i regjistruar më 1893 në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

LLUKAVCI I THATË - I banuar me pjesëtarë të komuniteteve pakicë (serbë, boshnjakë dhe ashkali), rreth 11 km në juglindje të Istogut.

Hasen gjurmë të vendbanimit të vjetër, si dhe mbishkrime të kohës romake (Mirdita, 1981: 259). Për herë të parë në dokumentet e shkruara përmendet me emrin **Llukavaq**, me 7 shtëpi, 4 beqarë dhe 1 e ve, përmendet më 1485 në Defterin e Sanxhakut të Shkodrës (Pulaha, 1974:298).

LUBOVA: Vendbanim kodrinor, rreth 18 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Kajtazaj, Hajdaj, Ademaj, Haxhijaj, Morina, si dhe disa familje boshnjake, serbe-malazeze dhe ashali.

Mikrotoponimet: Arat e Qarrit, Kroni i Mirë, Arat mi Shpi, Lisi i Zojës, Kroni i Bekës, Arat e Bashit, Arat e Gata, Rrahije, Arat në Breg etj. Te vendi i quajtur Lisi i Zojës janë zbuluar varreza të vjetra ilire. Mendohet se aty afër ka qenë një kishë e vjetër. Po ashtu edhe në vendin e quajtur Arat në Breg janë zbuluar gjurmë të themeleve të objekteve të vjetra, copëza qeramike etj.

LUBOZHDA: Vendbanim buzë malesh, rreth 4 km në perëndim të Istogut.

Patronimet: Idrizaj, Osaj, Pepaj, Lajçi, Duraku, Dautaj, Kadaj, Januzaj, Sejdiqaj, Qetina, Zeqiraj, Meshi.

Mikrotoponimet: Pollaqeri, Lugu i Dragiqit, Gradina, Shimeku, Kralica, Bradet, Kroni i Kodrës, Kanica, Prekaqa, Llugat e Mëdha, Batallina, Peshnjeva etj.

Gjetjet arkeologjike në këtë lokalitet (enë, byzylyk të argjendte me kokë gjarpri, një brez i argjendte, margaritarë të qelibartë, zinxhirë, shtizë metali etj.) dëshmojnë për një lokalitet iliro-dardan (si dhe gjermadhat e qytetit të vjetër - Gradinës). Më 1485 përmendet në DSSH me emrin Luboshta, me 10 shtëpi (Pulaha, 1974: 271).

Me të njëjtin emër, më 1893, përmendet në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

Shumë banorë shqiptarë të këtij katundi, veçmas familja shumëanëtarëshe Pepaj, u detyruan të shpërngulen në Turqi.

MOJSTIRI: Vendbanim kodrinor, rrëzë Malit të Mognës, rreth 4 km në lindje të Istogut.

Patronimet: Zekaj, Abazi, Alushaj, Beqiraj, Nekaj, Musaj, si dhe disa familje të kolonëve serbë e malazezë.

Mikrotoponimet: Harmoqi i Rexhës, Starasella, Kërshi i Zi, Tuma, Shtreznica, Liseca, Repishta, Tocila, Radusha, Gllama, Jerebi, Livadhi i Çrkës, Padina, Livadhi i Madh, Striminofci, Pravalia, Rudina, Samari, Kroni i Polanës, Kërshi i Kuq, Shipoti, Kroni i Mihanës, Shkoza, Vraci,

Cibreni, Jela etj. Në pjesën malore, lokaliteti antik **Stara Sella**, dhe në Shtreznica, gjenden gërmadhat e një kishe të vjetër. Përmendet në Defterin e Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, që ishte i ishte ndarë në dy pjesë, pra prona të dy feudalëve, njëra me emrin **Mostër** kishte 64 shtëpi, 10 beqarë dhe 2 të veja, ndërsa tjetra me emrin **Mostir** me 25 shtëpi e 2 beqarë (Pulaha, 1974:65).

MUZHEVINA: Vendbanim tipik fushor, me toka pjellore, rreth 4 km, në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Bardheci, Vuthaj, Ahmetaj, Alimetaj, Jahaj, Balaj, Gashi, Selmanaj, Shala, Dema, Bajramaj, Veselaj, Vekaj, Sylaj, Myrtaj, Dushi, Kolaj, Kurtaj, Sefaj, Qorraj, Shpatollaj, si dhe disa familje serbe-malazeze dhe egjiptiane.

Mikrotoponimet: Livadhet e Egra, Livadhet e Buta, Livadhi i Madh, Arat te Stani, Tërshevina, Lluga e Vogël, Botena, Mi Vade, Rrahishta, Jazi i Gogës, Progomet, Zallina etj. Te Livadhi i Madh janë gjetur gurë të mëdhenj, që mendohet se u takojnë varrezave të moçme. Fillimisht përmendet në DSSH të vitit 1485 me emrin **Muzevanja**, me 13 shtëpi, 1 beqar (Pulaha, 1974: 243). Në vitin 1893 përmendet me emrin Muzhovina në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

ORROBËRDA: Vendbanim i tipit të shpërndarë, rreth 13 kilometra në perëndim të Istogut. Patronimet: Pacaj, Zogaj, Hakaj, Miranaj, Turkaj, Mulaj, Hoxhaj, Avdijaj, Maksutaj, Muzlijaj.

Mikrotoponimet: Zhigu i Hafizit, Vorri i Malsorit, Balta e Thive, Liqeni i Sylëzeqirit, Kroni i Dydeshtit, Harkanoll, Bregu i Kishës, Lugu i Mllakisë, Livadhi i Zekës, Ledinat, Bunari i Kaurrit, Qenxha, Drenova, Prroni i Keq, Luginishta, Dubovci, Prroni i Shevarit, Fanxhe, Gurbuti, Kroni i Sahitit, Gjyzel etj.

Ndërmjet lagjes Pacaj dhe asaj Miranaj ekzistojnë varreza të moçme katolike shqiptare. Fillimisht përmendet në DSSH të vitit 1485 me emrin **Butin Brek**, me 20 shtëpi, 2 beqarë, 2 të veja (Pulaha, 1974:295). Në vitin 1543 përmendet në dokumentet e Patrikanës së Pejës.

OSOJANI: Lokalitet i banuar nga serbë e malazezë, rreth 18 km në juglindje të Istogut. Banorët shqiptarë janë zhvendosur nga ky katund. Mikrotoponimet: Drenja, Korman, Përlina, Qelia, Bregu i Haxhisë, Ara e Demirajve, Bara, Ara e Kajtazit, Kallilla, Breqa, Çeremida, Arrnica, Bresja, Lesha, Llokva, Beglluci, Bunqa, Brodi, Josha, Nerezina, Bogashica, Bregu, Villovishite, Rudenica, Saq, Quka, Qulina, Dunjiqe, Kunja, Piskulliqa, Vir, Llopqak etj.

Ky lokalitet përmendet për herë të parë në dokumentet e shkruara në vitin 1314 në kartën e mbretit Millutin (Stijović, 1982: 349-358).

PADALISHTA: Vendbanim kodrinor i tipit të shpërndarë, rreth 13 km në lindje të Istogut. Patronimet: Ahmetaj, Imeraj, Fetahaj, Loshaj.

Mikrotoponimet: Ata te Molla e Kuqe, Kroni i Logut, Bunari i Dërvishit, Gujafçi, Ara në Rrafsh, Fusha e Madhe, Kisha, Kodrat, Mellat, Lugu i Vraniqit, Ara te Zabeli, Lugu i Dërvishit, Ara e Ozmanit, Kunguleci, Livadhet e Epërme, Lugat, Lugu i Çitakve, Trolli i Hallës Razë, Ara e Broqit, Ku shemet Toka, Bunari i Keq, Vau, Xhadja, Vneshta, Zabeli, Bunari i Keq, Ograxha. Ky katund ndahet në dy pjesë. Vijë ndarëse është lumi Kujafç, që bën edhe ndarjen administrative të komunës së Istogut nga ajo e Skenderajt.

POLANA: Vendbanim, kodrinor-malor, rreth 25 km në juglindje të Istogut. Këtu jetojnë vetëm pak familje shqiptare, të besimit të krishterë (Pjetraj dhe Dodaj).

Mikrotoponimet: Hamarishta, Bara, Bregu, Zabeli i Zajmit, Konoplishta, Uji i Magjupit, Sokaku etj. Fillimisht përmendet me emrin Bolani, më 1314 në kartën e mbretit Millutin.

PREKALLA: Vendbanim kodrinor i tipit të shpërndarë, rreth 11 km në jug të Istogut.

Patronimet: Hoxhaj, Hasanaj, Zemaj Blakaj, Osmanaj, si dhe disa familje ashkali me mbiemrin Kosova dhe Zeqaj.

Mikrotoponimet: Rrahu i Azllan Nekës, Lugu i Imerajve, Shkalla e Kasapit, Lugu i Mullinit, Livadhi i Ilirëve, Ledina e Kresneshëve, Shpia e Kërstneshe, Tokat e Tishukve, Kroni i Mullinit t' Isniqit, Mullini i Hysen Sadikut, Livadhi i Madh, Te Drini, Mullini i Melve, Qepuraku, Bregu, Ledina e Tishukëve etj. Fillimisht përmendet në vitin 1893 në sallnamet e Vilajetit të Kosovës.

PRIGODA: Vendbanim fushor i tipit të shpërndarë, rreth 6 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Gashi, Dreshaj, Zeqiraj, Kabashi, Blakaj, Sadikaj, Mehaj, Shabanaj, Gorqaj, si dhe dy familje boshnjake (Qallaković).

Mikrotoponimet: Ner Jaze, Shovarina, Ramadane, Zabeli, Arat e Gata, Torrovaça, Rosula, Mujaheri, Meretë, Suderek, Gurina, Orrnica, Zallina, Arat e Vrell's, T' Thuret etj. Në vendin e quajtur Suderek janë gjetur gurë që mendohet se i takojnë një kishe të moçme shqiptare.

Fillimisht përmendet në Defterin Osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 me emrin Prikoda me 6 shtëpi, 2 beqarë e një të ve (Pulaha, 1974:242), ndërkaq, me emrin Përgoda, me 15 shtëpi, 2 beqarë dhe 3

bashtina, përmendet në Defterin Osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582 (Tapu Kadastra Arsivi Ankara, nr. 59. Rexha: 2001). Me emrin Bragoda, në vitin 1689, regjistrohet në një hartë të ushtrisë austriake.

RAKOSHI: Vendbanim kodrinor i tipit të shpërndarë. Shtrihet përgjatë rrugës Pejë-Mitrovicë, rreth 12 km në lindje të Istogut.

Patronimet: Hajrizaj, Haxhijaj, Muhaxhiri, Balaj, Tafilaj, Shala etj. Mikrotoponimet: Selishta, Stodorekë, Mella, Trollishta, Rrahina, Shavarina, Tefiq, Zmijanik, Smolica etj. Është prej vendbanimeve të vjetra, i banueshëm që nga periudha e neolitit dhe ajo e dardanëve. Fillimisht, përmendet në vitin 1253, ku mbreti serb Urosh Nemanja I, ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Stonit në Dubrovnik (Stijović, 1979: 302). Në DSSH 1485, përmendet me emrin Rakosh, me 18 shtëpi, 7 beqarë dhe 2 të veja (Pulaha, 1974:243).

SËRBOBRANI: Vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë, buzë rrugës magjistrale Pejë-Mitrovicë, rreth 18 km në jug të Istogut. Me emrin Serbobran është pagëzuar menjëherë pas kolonizimit, sipas Serbobranit të Baçkës në Vojvodinë. Nga banorët vendas njihet (quhet) me emrin e dikurshëm **Sovllak**.

SHALINOVICA: Vendbanim kodrinor-fushor rreth 15 km në jug të Istogut. Patronimet: Zeqiraj, Bajramaj, Desku, Berbati, Kerolli, Karcelli (Hasanaj), si dhe disa familje serbe e malazeze. Mikrotoponimet: Stupe, Samërdan, Boka e Kuqe, Kujafqi, Kamenica, Mali i Zagraxhve, Toka e Kapitve, Livadhet e Thata, Kulla e Kabashve, Shpijat e Salizeqirve etj. Te Shpijat e Salizeqirve hasen shenja të një vendbanimi të vjetër. Fillimisht përmendet në Kartën e Mbretit Stefan, në vitin 1314, si dhuratë për Manastirin e Banjskës.

SHUSHICA: Vendbanim kodrinor rreth 8 km në lindje të Istogut.

Patronimet: Sadikaj, Nimanaj, Abdylaj, Salihaj, Osmanaj, Metaj, Selimusaj, Mulaj, Zekaj, Ibrahimaj, Halilaj, Jahaj.

Mikrotoponimet: Vojdulli, Bregu i Hanit, Vorret e Katunit, Kërshi i Ramës, Arat e Dubravës, Te Kisha, Kroni i Popit, Rrepishta, Kërshi i Palit, Lugjet, Kroni i Alqikit, Boavica, Kërrshi i Fazlisë, Kroni i Vojdullit, Kërshi i Vogël, Mokna, Vojdulli, Livadhet e Selibres, Trolli i Sejdi Sakës, Soishta, Arat e Metovite, Prrojet, Lumbregu, Lepishta etj. Në Starasellë, hasen gjurmë të një vendbanimi të vjetër. Po ashtu, edhe te Kroni i Popit ka gjurmë të një kishe të vjetër. Fillimisht përmendet në kartën e Mbretit Uroshi I në vitet 1254-1265. Më 1348 në Kartën e mbretit Dushan, dhuratë shenjtorëve Mihail e Gabriel (Novaković, 1912: 464). Me emrin Sushiqani (Grković, 1983:17) përmendet në vitin 1330 në Krisobulën kishtare të

Manastirit të Deçanit, ku jetonte edhe popullsia vllehe. Më 1485, në DSSH me emrin **Shushica**, me 28 shtëpi, 5 beqarë e 5 të vej (Pulaha, 1974:202).

SINEJA: Vendbanim kodrinor rreth 4 km në lindje të Istogut.

Patronimet: Avdijaj, si dhe disa familje serbe e malazeze.

Mikrotoponimet: Kodra e Krekcit, Bregu, Kodra e Bardhë, Çuka e Madhe, Rudina, Vekshi, Kungullari, Rudeshti, Lugu i Madh, Kroni i Imerit, Rudina e Vogël, Vorret e Kuqit, Rrafshi, Ruishta, Mali i Rrallë, Llokva, Kërshi i Sokolit, Guri i Shiut, Qelijat, Çuka e Madhe, Bunari i Kadrisë, Qerepi, Pavlaqët, Bregu i Madh, Kroni i Shelnjes, Shkalla e Madhe, Prroni i Keq, Shkalla e Vogël, Selishta, Lugu i Hanit, Kroni i Mihanës, Lugu i Hulit, Balushat, Lugu i Gatë, Vuqa, Gropa e Egër etj.

Te Çuka e Madhe, janë zbuluar themelet e një kështjelle të madhe, ndërkaq në vendin e quajtur Selishtë, është hasur në copëza të qeramikës dardane.

Fillimisht përmendet më 1348 me emrin **Sinainci**, në kartën e mbretit Dushan, dërguar manastirit të Shën Gabrielit dhe të Mihajlit, afër Prizrenit (Osmani, 2004:145).

Në DSSH më 1485 përmendet me emrin Suniça me 3 vojnuk (Pulaha, 1974:406).

STARADRANI: Vendbanim fushor, rreth 11 km në jugperëndim të Istogut.

Patronimet: Berisha, Elshani, Mavraj, Etemaj, Grabofci, Thaçi etj.

Mikrotoponimet: Gurina, Llugat, Derbeshi, Krivaça, Pavada, Rija, Seishta, Preka, Llazina, Raxhevcit etj. Këtu janë zbuluar varreza mesjetare. Mendohet se në Mesjetë këtu ka ekzistuar një fortifikatë e madhe. Në Seishta janë gjetur tulla dhe gurë të moçëm. Janë zbuluar edhe shumë fragmente të monumenteve epigrafike ilire. Në DSSH më 1485, përmendet me emrin **Stara Andovrani**, me 12 shtëpi, 2 beqarë, 1 të ve (Pulaha, 1974:334).

VERIQI: Vendbanim fushor rreth 9 km në juglindje të Istogut.

Patronimet: Delijaj, Muslijaj, Ibrahimaj, Sylkaj, Boletini, Haxhijaj, Geci, Loshi, Dakaj, Bushi, Kaqkini, Ramaj, Balaj, Igrishta, si dhe disa familje boshnjake, serbe-malazeze.

Mikrotoponimet: Kalugjerovica, Makva, Joshe, Kodra e Jaklinës, Drejana, Shushica, Bllakaq, Qerhane, Bakqina, Qesta, Llojze, Karaulla, Trojan, Arrnica, Kuka etj. Në pjesën malore janë zbuluar varreza (gurë me kryqa të skalitur dhe një kalorës me kalë (Stijović, 1982:254). Përmendet në vitin 1316 në kristobulën e Shën Stefanit, dhe më 1348 në kartën e Car Dushanit (Zadužbine Kosova, 1987:414). Në DSSH përmendet me emrin **Veriq**, me 21 shtëpi, 4 beqarë, 3 të veja (Pulaha, 1974:319).

VERIQI I RI: Vendbanim i ri, i formuar pas Luftës së Parë Botërore, në jug të Veriqit. Banorët e parë shqiptarë, u vendosën në vitin 1954, fillimisht familja Hajzeri, pastaj familja Rrahmani e më vonë edhe familje të tjera.

VRELLA: Vendbanim buzë bjeshkëve, por edhe në pjesën fushore, rreth 7 km në perëndim të Istogut. Patronimet: Dreshaj, Bicaj, Maraj, Mavraj, Haxhijaj, Demaj, Rugova, Maxharraj, Blakaj, Dakaj, Berisha, Vuthaj, Ferizaj, Sadrijaj.

Mikrotoponimet: Lugu i Madh, Leskoviku, Krye, Prroni i Keq, Shpella e Dhive, Kërrshi i Kuq, Loxhe, Kërrshi i Rxum, Shpella e Barutit, Kungullari, Gurra e Sefisë, Lugu i Shkozës, Pehari, Mi Udhat, Mali i Djegun, Te Krojzit, Guri i Qaplës, Papurina, Ku u vra Halil Osmani, Tedeli, Pâjat, Ahi i Pushimit, Kroni i Metës, Shtrashniku, Vorri i Nuses, Rrahijet, Lugu i Butë, Te Bira e Arushs, Shpella e Hoxhs, Prrojet, Lama e Dakaj, Prroni i Bicit, Ara e Ferizit, Shavarina, Kodra e Dynës, Bira e Hutit, Shkalla e Selman Keçit, Te Hazir Dajt etj.

Këtu është gjetur një enë me monedha romake dhe sot ruhet në Muzeun Arkeologjik të Zarës dhe në Muzeun e Beogradi (Marić, 1956:180). Janë hasur varreza të moçme (banorët i quajnë varrezat latine).

Fillimisht përmendet më 1397 kur princesha serbe Milica ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Deçanit (Zadužbine Kosova, 1987: 418). Në DSSH 1485, përmendet me emrin **Vorodka**, me 16 shtëpi, 6 beqarë, e 2 të veja (Pulaha, 1974:162) Në DSSH të vitit 1582 përmendet me emrin **Vrella**, me 43 shtëpi, 14 beqarë dhe 3 bashtina dhe i takonte manastirit të Kazasë së Pejës (Tapu Kadastra Arsivi Ankara, nr. 59. Rexha, 2001).

ZABLLAÇI: Vendbanim fushor ndërmjet lumenjve Drini i Bardhë dhe Istog, rreth 13 km në jug të qytetit të Istogut.

Patronimet: Balaj, Mehmetaj, Ahmetaj, Dervishaj.

Mikrotoponimet: Lluga e Madhe, Jazi i Gogës, Livadhet te Ura e Gurit, Glipce, Bahqe, Bishtaqe, Bare. Banorët e këtij katundi janë të ardhur nga disa katunde të komunës së Deçanit, ndërkaq të dhënat historike për këtë vendbanim, janë fare të pakta.

ZALLÇI- Vendbanim i tipit të shpërndarë rreth 12 km në juglindje të Istogut.

Patronimet: Ibrahimaj, Ukaj, Mulaku, Shalaj, Kelmendi si dhe disa familje ashkali dhe serbe e malazeze. Mikrotoponimet: Vorret e Turqve, Shpati, Kodra, Ura e Gurit, Vorret e Shkive, Livadhet e Thata, Kuklica, Gjelibzina, Kodra etj. Më 1485 në DSSH përmendet me emrin **Zhaleç**, me 29 shtëpi dhe 6 beqarë (Pulaha, 1974: 255).

ZHAKOVA- Vendbanim kodrinor rreth 13 km në lindje të Istogut.

Patronimet: Hajrizaj, Brahimaj, Hysenaj, Idrizaj, Salihaj, Sejdiqaj, Mehmetaj.

Mikrotoponimet: Malet e Vogla, Ara e Rxume, Zabeli i Izlamit, Prroni i Zhakovës, Prrocka, Arat e Batriqit, Logjet, Mali në Shpat, Livadhi i Shpatit, Mi Shavarina, Livadhi te Vorret, Osmonica, Javori, Maja e Madhe, Kosharishta, Livadhi i Qelun, Ograje, Stropci etj. Gjenden themelet e një kishe katolike, si dhe varreza të vjetra. Fillimisht, përmendet më 1331 në kartën e mbretit Dushan që ia kishte bërë dhuratë Manastirit të Hilandarit (Novaković, 1912:444). Më 1485 në DSSH, me emrin **Zakova**, me 21 shtëpi e 3 beqarë (Pulaha, 1974:218).

BIBLIOGRAFI

- Ajeti, I. (1975), *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosne e Hercegovinës dhe të Kosovës*, GJA, SSHF, IV. Prishtinë. IAP.
- Dodi, A. (2004), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë*, (1962) Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, vëll. II, Shek. VIII- XV. Tiranë.
- Cvijić, J. (1966), *Balkansko poluostrvo i Južnoslovensko zemlje*. Beograd.
- Çabej, E. (1959), *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Çerškov, E. (1969), *Rimljani na Kosovu i Metohiji*. Beograd.
- Drançolli, F. (2000), *Ndërtime kulti të krishterë iliro-shqiptar*, në: “Dardania Sacra” (2), Prishtinë.
- Drançolli, J. (2008), *Kontinuiteti iliro-arbëror në arealin e Kosovës*. Prishtinë. Thesis Kosova, (1), 29.
- Filipović, M. (1967), *Različita etnološka gradja*. Beograd.
- Gashi, S. (1979), *Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shek. XIII-XIV*. Prishtinë.
- Grković, M. (1983), *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, Novi Sad.
- Grup autorësh (1973), *Kosova dikur e sot*. Beograd. “Kultura”.
- Gjinari, J. & Shkurtaç, Gj. (2003), *Dialektologjia*. Tiranë: SHBLU.
- Jastrebov, I. (1901), *Stara Srbija i Albanija*. Beograd.
- Jireček, K. (1962), *Nauka i Umetnosti Zbornik II*, Srpska Akademija, Beograd.
- Korać, V. (1979), *Studenica Hvostanska*, Beograd.

- Malcolm, N. (2011), *Kosova një histori e shkurtër*. Prishtinë: "Koha".
- Marić, R. (1956), *Ostave starog novca u Numizmatičkoj zbirici Narodnog muzeja u Beogradu*, Saopštenja I, Beograd.
- Mirdita, Z. (1981), *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake*. Prishtinë. "Rilindja".
- Mulaku, L. (2005), *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë. IAP.
- Murati, Q. (2014), *Disa patronime dhe toponime të Kosovës në vështrimin etimologjik*, GJA, SSHF, (43), 41-42.
- Novaković, S. (1912), *Zakonci spomenici srpskih zemalja srednjeg veka*. Beograd.
- Jashar, N.-O. (1998), *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*. Shkup. "Logos-a".
- Obradović, M. (2005), *Reforma Agrare dhe kolonizimi i Kosovës*, Prishtinë. Instituti i Historisë.
- Osmani, J. (2004), *Vendbanimet e Kosovës, Burimi (Istogu)*. Prishtinë. "Dukagjini".
- Pokrajinski zavod za statistiku, (1984). *Stanovništva prema narodnosti i naseljenim mestima u SAP Kosovo*, Priština, bilt.33., 96, 54, 46.
- Pulaha, S. (1972), *Nahija e Altun-Ilisë dhe popullsia e saj në fund të shek. XV*, GJA, SSHH (1), 193-272.
- Pulaha, S. (1974), *Defteri i Sanxhakut të Shkodrës 1485, vëllimi I. Tiranë.* "Mihal Duri".
- Pulaha, S. (1983), *Popullsia e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*. ASSH. Tiranë.
- Radovanović, M. (1959), *Varošica Istok u Metohijskom Podgoru*, IV. Beograd. Zbornik radova Geografskog Instituta.
- Raka, F. (2004), *Areali gjuhësor i Kaçanikut*. Prishtinë.
- Stijović, S. (1982), *Onomastika zapadnog dela metohijskog Podgora*, Onomatološki prilozi III. Beograd.
- Stijović, S. (1979), *Onomastika istočnog dela Metohijskog Podgora*, Onomatološki prilozi I. Beograd.
- Tërnavë, M. (1995) *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*. Prishtinë. IAP.
- Xhemaj, U. (2003), *Etnokultura shqiptare në Podgur* (monografi etnologjike), Prishtinë. IAP.
- Zadužbine Kosova (1987), Prishtinë-Beograd.
- Zymberi, A. (2015), *Fjalor popullor me rreth 20000 fjalë*, Prishtinë.
Të dhëna të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog për vitin shkollor 2015/2016.